



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 si dhe neni 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 30. 10. 2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 50,000 € (pesëdhjetë mijë) euro, me destinim për subvencionimin –ndërtimin e shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë sociale në Komunën e Lipjanit.

II. AUTORIZOHET, Kryetari i Komunës që menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të negociojë dhe të lidhë Marrëveshje bashkëpunimi me organizatat e ndryshme të shoqërisë civile vendore, ndërkombëtare apo donatorët e ndryshëm për bashkëfinancim në ndërtimin e shtëpive për familjet me kushte të rënda sociale.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës- kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës.

Nr.15- 400-70944

Lipjan, më 31. 10. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

